



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.23, datë 1.12.2017

Për

***“Mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”***

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

|                |          |         |
|----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir     | Zela     | Kryetar |
| 2. Z. Alban    | Karapici | Anëtar  |
| 3. Zj. Anila   | Denaj    | Anëtar  |
| 4. Zj. Ketrin  | Topçiu   | Anëtar  |
| 5. Zj. Klarina | Allushi  | Anëtar  |

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 1.12.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Mbylljen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”***

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;
4. Rregullore e AKEP me nr.18, datë 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”;

5. Rregulloren e AKEP me nr.19, datë 14.06.2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin”, e ndryshuar.

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.14, datë 20.07.2017, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunications sh.p.k. – Albtelecom sh.a.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 3934/6 Prot. datë 04.08.2017 (nr.1621/6 Prot. Datë 04.08.2017 i AKEP) “Mbi depozitimën e pretendimeve të Albtelecom në zbatim të Vendimit nr.14, dt.20.07.2017 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k dhe Albtelecom sh.a””, njoftuar nga AKEP me shkresën nr.1621/2 dt.20.07.2017 (prot. Albtelecom Nr.4980, dt.21.07.2017);
- Shkresa e Elite Telecommunication sh.p.k me nr.25/08 Prot. datë 08.08.2017 ( nr.1621/7 Prot., datë 08.08.2017 i AKEP) “Pretendimet dhe parashtrimet e Elite Telecommunications sh.p.k, në zbatim të vendimit të AKEP Nr.14, datë 20.07.2017 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k dhe Albtelecom sh.a””;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 3934 Prot. datë 08.06.2017 “Njoftim për shkelje”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.3934/1 Prot. datë 19.06.2017 “Shpjegime për rritjen e trafikut nga Elite Telecommunication sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.3934/2 Prot. datë 29.06.2017 “Njoftim për pezullimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.3934/3 Prot. datë 06.07.2017 “Mbi korigjimin e shkeljes, kompesimin dhe faturimin e vlerës financiare, shkaktuar nga trafiku në shkelje të MI nga ana e Elite Telecommunication sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.3934/4 Prot. datë 11.07.2017 “Kundërshtim i faturave Nr.90705010, datë 05.07.2017 dhe Nr.90705011 datë 05.07.2017 dërguar nga Albtelecom”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.3934/5 Prot. datë 17.07.2017 “Në përgjigje tuajës nr.11/07 prot. datë 11.07.2017 dhe rikthimin e faturave të kundërshtuara, për shlyerjen e vlerës financiare, shkaktuar nga trafiku në shkelje të MI nga ana e Elite Telecommunication sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr.2491/1 Prot. datë 20.05.2016 “Në përgjigje tuajës nr.2491 prot. datë 24.03.2016”;
- Shkresa e AKEP Nr. 1621/8 Prot. datë 13.09.2017 “Ftesë për seancë dëgjimore”;
- Shkresa e AKEP Nr. 1621/9 Prot. datë 19.09.2017 “Njoftim për shtyrje afati”;

- Shkresa e AKEP Nr.1621/10 Prot. datë 25.09.2017 “Kërkesë për depozitim të provave shtesë”, drejtuar Albtelecom sh.a;
- Shkresa e AKEP Nr.1621/11 Prot. datë 25.09.2017 “Kërkesë për depozitim të provave shtesë”, drejtuar Elite Telecom sh.p.k;
- Shkresa e Elite Telecom Nr.1621/12 Prot. datë 05.10.2017 “Dërgim CDR”;
- Shkresa e Elite Telecom Nr.1621/13 Prot. datë 06.10.2017 “Përgjigje shkresës tuaj nr.1621/10 datë 25.09.2017”;

**si dhe:**

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

**V Ë R E N:**

1. AKEP bazuar në kërkesën e sipërmarrësit Elite Communication sh.p.k me anë të Vendimit nr.14, datë 20.07.2017, “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunications sh.p.k dhe Albtelecom sh.a.*”, vendosi fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke i’u kërkuar palëve që brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit të depozitohen pretendimet e tyre në lidhje me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.
2. Sipërmarrësi Albtelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 3934/6 Prot. datë 04.08.2017 (nr.1621/6 Prot. Datë 04.08.2017 i AKEP) “*Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom në zbatim të Vendimit nr.14, dt.20.07.2017 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k dhe Albtelecom sh.a.”*”, ka dërguar pretendimet e tij duke argumentuar ndër të tjera si vijon:
  - Operatori Elite Telecommunications, nuk paraqiti asnjëherë qoftë edhe ndonjë provë të vetme (sic kërkohet nga Marrëveshja e Interkoneksionit) që të mund të mbështeste apo provonte pretendimet e tij për trafik kombëtar të abonenteve të Elite Telecommunications;
  - Albtelecom duke qënë i qartë mbi detyrimet ligjore në lidhje edhe me mbrojtjen e të dhënave personale, ka specifikuar që në njoftimin e parë të tij nr. 3934 dt. 08.06.2017 se edhe në kuadër të detyrimit për mbrojtjen e të dhënave, operatori Elite mund ti anonimizonte/fshihte të dhënat e pajtimtarëve apo të dhënat e kontratës që përbëjnë elemente për mbrojtjen e të dhënave personale;
  - Albtelecom njoftoi Elite Telecommunication për pezullimin e shërbimeve me shkresën nr. 3934/2 dhe pezullimi i interkoneksionit u krye vetem pas edhe dy komunikimeve të tjera elektronike (email i datës 30.06.2017 dhe email i datës 03.07.2017 ) dhe konkretisht me datë 03.07.2017, ora 16:30. Pra, edhe në këtë rast, operatorit Elite i’u sigurua edhe një kohë tjetër e mjaftueshme për të korrigjuar shkeljen apo për të paraqitur ndonjë provë apo dokumentacion në mbështetje të pretendimeve të tij;

- Albtelecom siç kishte argumentuar dhe njoftuar edhe me shkresën e mëparshme nr. 3934/3 dt. 06.07.2017, në zbatim të nenit 23, pika 5 e Marrëveshjes të Interkoneksionit, i ka rikërkuar operatorit Elite me shkresën nr. 3934/5 dt.17.07.2017 likujdimin e detyrimeve financiare sipas faturave të lëshuara nga Albtelecom (fatura nr.90705010, datë 05.07.2017 dhe nr.90705011, datë 05.07.2017) dhe njëkohësisht i kemi rikujtuar operatorit Elite se Albtelecom do të procedojë deri në zgjidhjen përfundimtare të Marrëveshjes sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Interkoneksionit nëse operatori Elite nuk korrigjon plotesisht shkeljen dhe dëmin e shkaktuar nga kjo shkelje;
  - Nga ana e Operatorit Elite Telecommunication, këto janë sjellje abuzive të përsëritura me trafikun e terminuar në rrjetin e Albtelecom të cilat janë kryer edhe në muajin Shkurt - Mars të vitit 2016, çështje për të cilën Albtelecom i është drejtuar AKEP dhe nga ana e këtij të fundit në zbatim të ligjit nr. 9918, ndryshuar me ligjin 102, dt. 24.10.2012 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe të Rregullores "Inspektimin, Monitorimin e Spektrit te Frekuencave dhe Masat Administrative", për sipërmarrësin "Elite Telecommunications" shpk, u vendos masa administrative me gjobë, njoftuar Albtelecom-it me shkresën e AKEP nr. 660/2 dt. 19.05.2016.
3. Albtelecom në shkresën nr.2934/2 prot., datë 29.06.2017, drejtuar Elite Telecommunication dhe për dijeni AKEP, për njoftimin për pezullimin e shërbimeve të interkoneksionit për Elite, sqaron se pretendimi i Elite për përdorim të numrave të alokuar nga AKEP për Telemarketing të kompnisë së vet, është në kundërshtim me:
- a. Përcaktimet e MI-së, neni 2 (pika1), neni 8 (pika 1) dhe neni 11 (pika4), pasi interkoneksioni shërben për të lidhur pajtimtarët e dy rrjeteve për komunikim me njëri-tjetrin dhe se asnjë nga palët e MI-së nuk do dërgojë apo detyruar të përcjellë/pranojë rthirje (shërbime trafiku) të ndonjë kategorie të papërcuktuar në MI, pa miratimin paraprak midis palëve;
  - b. Autorizimin e Përgjithshëm, pasi objekti i autorizimit është përdorimi i rrjetit dhe numeracionit për ofrim të shërbimeve për përdoruesit fundorë dhe jo për qëllime vetjake të operatorit për ploëtsimin e nevojave të bizneseve të tjera të sipërmarrësit;
  - c. Qëllimin e përdorimit të numeracionit gjeografik të alokuar nga AKEP për alokim dytësor për përdoresit fundorë të shërbimeve të telefonisë fikse (në 10 muajt e fundit Elite nuk ka pasur asnjë minutë thirrje drejt Albtelecom fiks dhe mobile), dhe duket se Elite nuk ka ansjë përdorues fundor.
4. Sipërmarrësi Elite Telecommunications sh.p.k me anë të shkresës me nr.25/08 Prot. datë 08.08.2017 ( nr.1621/7 Prot., datë 08.08.2017 i AKEP) "Pretendimet dhe parashtrimet e Elite Telecommunications sh.p.k, në zbatim të vendimit të AKEP Nr.14, datë 20.07.2017 për "Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Elite Telecommunication sh.p.k dhe Albtelecom sh.a", ka dërguar pretendimet e tij duke argumentuar ndër të tjera si vijon:

- Albtelecom nuk paraqet asnjë provë që trafiku është i natyrës që Albtelecom e quan “Bypass”;
- Elite Telecommunications sh.p.k ka shtuar në aktivitetin tregtar edhe tregtimin e disa produkteve si dhe ka ngritur një Call Center për shitjen e produkteve. Elite Telecommunications sh.p.k, disponon Listë Pagesat e punonjësve të mbajtura, paguara dhe dorëzuara konform legjislacionit në fuqi, për të provuar që janë punonjësit tanë që kryejnë telefonata, me numrat tanë;
- Albtelecom ka vepruar në shkelje të:
  1. Marrëveshjes së interkoneksionit mes paleve,
  2. RIO-s së saj në fuqi,
  3. Ligjit 9918,
  4. Rregullores përkatëse të AKEP për Interkoneksionin,
 duke njoftuar në datën 30.06.2017 me email dhe jo me shkresë zyrtare, për pezullimin e interkoneksionit në datën 03.07.2017 ora 08.00;
- Të dhënat e kërkuara nga Albtelecom, pra të dhënat personale në kontratat me abonentët, është e ndaluar të transferohen, nga Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin Nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nuk kanë të bëjnë me Albtelecom, por janë marrëdhënie mes Elite dhe Institucioneve Shtetërore përkatëse;
- Faturimi nga ana e Albtelecom tatóhet dhe raportohet korrekt çdo muaj sipas Ligjit përkatës dhe Rregullave Tatimore dhe nuk mund të gjenerojë faturë për veten e tij;
- Numrat tanë (të Call Center tonë), janë të thirrshëm (të telefonueshem) nga çdo numër në Republikën e Shqipërisë, pra janë numra reale të serisë numerike që na ka caktuar AKEP. Elite Telecom ka të gjithë të drejtën ligjore të përdorë numra të saj, nga seria numerike e caktuar nga AKEP edhe për nevoja të veprimtarisë së saj tregtare;
- Elite nuk ka tjetërsuar trafik dhe nuk ka bërë trafik “Bypass”. Nëse do të ishte i tillë, trafiku do të ishte kryer drejt numrave mobile të Albtelecom ose do të ishte kryer drejt operatoreve celulare. Pra, është shumë e qartë që Albtelecom ka vepruar bazuar në dyshime dhe jo në prova;
- Ndërpërja e padrejtës e Interkoneksionit, e cila ka shkaktuar dëme financiare direkte dhe indirekte është në shkelje të hapur të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr.9121, datë 28.7,2003, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10317, datë 16.9.2010;
- Për sa më sipër kërkojmë nga AKEP:
  1. Të detyrojë Albtelecom, të rihapë/rilidhë menjëherë marrëveshjen e interkoneksionit, sepse kemi ankesa nga abonentët për prishje të kontratave me Elite gjë që shton dëmin financiar ndaj Elite. Elite garanton

- që trafiku ka qënë dhe do të jetë nga pajtimtarët e Elite dhe nga numeracioni i Elite;
2. Të detyrojë Albtelecom të mos gjenerojë ndaj Elite faturë të gabuar për trafik “Bypass” sepse nuk ka qënë i tillë. Fatura të lëshohet për trafik kombëtar, sepse i tillë ishte;
  3. Te zgjidhë këtë mosmarrëveshje në kohën më të shkurtër të mundshme, për arsye së dëmet ekonomike që janë shkaktuar nga ndërprerja e interkoneksionit nga Albtelecom janë shumë të mëdha dhe po llogariten çdo ditë për çështjen gjyqësore që mund të hapet ndaj Albtelecom.
5. Elite Telecommunication në shkresën me nr.prot 13/06, datë 19.06.2017, dërguar Albtelecom dhe për dijeni AKEP, ka sqaruar se ai përdor numrat 45050030-45050059 për qëllime të telemarketing për aktivitetet e tjera të kësaj kompanie që nuk kanë lidhje me komunikimet elektronike. Elite ka sqaruar se përdorimi i kësaj pjese të numeracionit për qëllime telemarketing kryhet me “predictive dialer”, i cili është një sistem që kryen thirrje dalëse në mënyrë automatike duke ndihmuar agjentët e shitjeve për monitorimin e sinjaleve të zëna, voicemail etj. Gjithhstu Elite sqaron Albtelecoms e problemet në vitin e kaluar për trafikun by-pass drejt Albtelecom ishin për shkak të hack-imit të sistemit të Elite dhe komunikimi midis palëve e ndihmoi të zgjidhte problemin.
  6. Komisioni për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, i ngritur me VKD nr.14, datë 20.07.2017, me shkresë Nr.1621/8 Prot., datë 13.09.2017 ftoi operatorin Elite Telekom në një seancë dëgjimore për dhënien e sqarimeve të mëtejshme. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 21.09.2017. Gjatë seancës dëgjimore operatori Elite Telecommunication konfirmoi dhe njëherë atë që kishte shpjeguar në pretendimet e tij se nga AKEP i është akorduar një bllok numrash dhe nga këto një pjesë është përdorur nga Elite për nevoja të veta, për fushatën promocionale për shitjen e produkteve detergjente, pasi Elite, përvec fushës së telekomunikacionit është e involvuar dhe në prodhimin, ambalazhimin dhe shpërndarjen e produkteve detergjentë. Elite sqaroi Komisionin se nuk mund të lëshojë faturë për një shërbim të ofruar nga vetë ai dhe për më tepër theksoi se nga blloku i numrave te Elite janë kryer thirrje hyrëse dhe dalëse dhe ai mund të provonte gjithshka lidhur me identifikimin e këtyre thirrjeve. Nga Komisioni u kërkua që të depozitonte pranë AKEP, kopje të CDR-ve të përmendur, me qëllim që të administrohen në cilësinë e provës.
  7. Në kushtet kur operatori Elite dhe Albtelecom nuk depozituan asnjë provë shtesë nga pretendimet e dërguara, Komisioni me shkresë Nr.1621/10 Prot. dhe 1621/11 datë 25.09.2017, i'u drejtua të dy operatorëve duke i kërkuar që të depozitonin brenda datës 05.10.2017 prova shtesë dhe informacion të detajuar për thirrjet bazuar në CDR të sistemeve të tyre të faturimit.
  8. Me shkresë Nr.1621/12 Prot. datë 05.10.2017 operatori Elite Telecom depozitoi kopje të CDR-ve të veta. Me shkresë Nr.1621/13 datë 06.10.2017 operatori Albtelecom depozitoi kopje të CDR-ve, në lidhje me thirrjet e kryera nga Elite Telecom për periudhën Janar – Korrik 2017.
  9. Këshilli drejtues i AKEP pasi është njohur me Raportin e Komisionit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, i ngritur me VKD nr.14, datë 20.07.2017, pas shqyrtimit të

pretendimeve të palëve, të dërguara me shkresat dhe komunikimet e sipërcituara, vlerëson se:

- a. Rregullorja e Akses dhe Interkoneksionit, në nenet 9-11 ka një sërë përcaktimesh për modifikimin apo fshehjen e CLI duke i dhënë të drejtën palës pretenduese për marrjen e masave (deri në pezullim të interkoneksionit) në rastet e pretendimeve të bazuar në fakte për tjetërsim të trafikut nëpërmjet modifikimit të CLI, si dhe të përgjegjësissë së dëmshpërblimit të palës tjetër në rast se nga Gjykata kompetente pala pretenduese gjendet fajtores për pezullim jo të bazuar në kuadrin rregullator dhe ligjor. Këto përcaktime të Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit janë reflektuar në ofertën referencë të interkoneksionit (ORI) të Altelecom.
- b. ORI e Altelecom si dhe Marrveshja e Interkoneksionit e lidhur midis palëve më datë 16.11.2015, në nenin 15, pika 7 dhe 8 përcaktojnë se:
  - *Pala pretenduese e shkeljes do te konsideroje prove te mos modifikimit/tjetersimit te CLI, deftesen tatimore qe sipermarresi paguan prane organeve tatimore te RSH per faturat/faturen e atyre/atij abonenteve/abonenti nga numri i te cileve/cilit figuron te jete origjinuar thirrjet/thirrja, CLI e te cilave/te ciles pretendohet te jene/jete modifikuar. Njekohesisht me kerkesen e pales pretenduese te shkeljes, sipermarresi duhet ti vere ne dispozicion kopje te kontrates me pajtimtarin nga numri i te cilit jane gjeneruar thirrjet dhe njekohesisht faturat e ketij pajtimtari. Pala pretenduese do te vijojte pezullimin e sherbimeve deri ne momentin e paraqitjes dhe verifikimit te provave te mesiperme.*
  - *Pala pretenduese e shkeljes do provoje dyshimet e saj per modifikim te CLI apo tjetersim te trafikut mbi evidenca qe lidhen me volumin normal te trafikut te operatorit. Origjinimi i nje numri te konsiderueshem thirrjesh nga nje range i caktuar numeracioni ne nje hark kohor te caktuar, kohezgjatjes mesater te bisedes, evidentimin e bisedave te shumefishta, mungesen e informacioneve te pershkruara ne 7 etj.*
- c. Dyshimet e Altelecom për modifikim të CLI-së janë bazuar në rritjen e ndjeshme të trafikut të dërguar nga Elite Telecommunication drejt Altelecom. CDR-të e depozituara nga të dy palët vërtetojnë rritjen e ndjeshme të trafikut nga Elite, dhe ky operator e ka pranuar këtë fakt, por pretendon se rritja e ndjeshme e trafikut ka ardhur nga përdorimi i 30 numrave (seria 45050030-45050059) për telemarketing.
- d. AKEP ka alokuar për Elite Telecommunication serinë numerike gjeografike 4.5.050.000-4.5.052.999 për përdorim të tyre për ofrim të shërbimit të komunikimit publik telefonik nga rrjete fikse, pra për pajtimtarë të telefonisë fikse. Nga të dhënat statistikore të depozituara në AKEP, Elite ka raportuar të dhënat e mëposhtëme për numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse.

| Periudha | Numri i pajtimtarëve të telefonisë fike |
|----------|---|
| T4 2015  | 7                                       |
| T1 2016  | 10                                      |
| T3 2016  | 12                                      |

|           |    |
|-----------|----|
| Viti 2016 | 15 |
| T1 2017   | 21 |
| T2 2017   | 5  |

Në fund të vitit 2016 Elite ka raportuar se 12 pajtimtarë janë të kategorisë Familjare dhe 3 të kategorisë Biznes, si dhe teknologjia e linjave të telefonisë fikse është lidhje pa tela (ëireless) për të gjitha linjat. Elite ka raportuar vetëm ofrim të shërbimit telefonik në Tiranë dhe asnjë pajtimtar me akses broadband nga rrjet fikse.

Raportimi për rrjet aksesi lokal pa tela nuk është në përputhje me njoftimin për autorizimin e përgjithshëm të Elite, pasi në regjistrin e sipërmarrëve të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të AKEP, rrjeti i aksesit të Elite është njoftuar me përcjellësa metalike dhe fibër optike.

- e. Nga analiza e CDR-ve të dërguara nga palët për periudhën Janar-Korrik 2017 vihet re se:
- Në muajt Janar-Prill 2017 trafiku i thirrjeve dalëse të Elite ishte 73-222 minuta në muaj apo 15-40 thirrje në muaj. I gjithë ky trafik është gjeneruar nga një numër i vetëm i Elite dhe shumica e thirrjeve (89 nga 106) dhe trafikut (98%) janë drejt numrit të kontaktit të sipërmarrësit Elite Telecommunication. Në Maj 2017 ka një rritje të ndjeshme të trafikut në rreth 11 mijë minuta dhe në Qershor arriti në rreth 44 mijë minuta. Këto përbëjnë afërsisht 4000-9000 thirrje në muaj.
  - Për thirrjet hyrëse në rrjetin Elite, të gjeneruara nga Albtelecom apo operatorë të tjerë, në muajin Janar janë kryer vetëm 3 thirrje në total 1 minutë, ndërsa në Shkurt-Prill 2017 nuk ka asnjë thirrje të terminuar në rrjetin Elite. Në Maj-Qershor totali i thirrjeve hyrëse në Elite ishte 93-104 minuta në muaj, apo rreth 142-163 thirrje në muaj. Në këtë periudhë vihet re se 19 thirrje të përcjella nga Albtelecom për terminim në rrjetin Elite janë thirrje të origjinuara nga vet numrat e Elite 45050030-45050059. Pra thirrje brenda rrjetit Elite janë kryer me tranzitim nga rrjeti i Albtelecom.
- f. Megjithëse CDR-të nuk mund të tregojnë nëse ka pasur ose jo tjetërsim të CLI-së apo përdorim vërtet për Telemarketing sipas pretendimeve të secilës palë, ato evidentojnë rritjen e ndjeshme të trafikut dalës të Elite dhe se ky sipërmarrës përdor numeracionin gjeografik të alokuar nga AKEP kryesisht për shërbimet e Telemarketing për kompaninë e vet (sipas pretendimit të tij), dhe jo për ofrim të shërbimeve të komunikimit publik telefonik për pajtimtarë. Gjithashtu rrugëzimi i disa thirrjeve brenda rrjetit të Elite nëpërmjet rrjetit Albtelecom nuk është në linjë me funksionimin normal të rrjeteve publike të telefonisë fikse. Përdorimi i sistemeve të tilla (predictive autodialer) që gjenerojnë mijëra thirrje në mënyrë automatike pa njoftuar palën tjetër të interkonektuar krijon probleme dhe në funksionimin e rrjeteve të interkonektuar por edhe mund të klasifikohet si jashtë objektit/qëllimit kryesor të interkoneksionit të rrjeteve publike telefonike.



- g. Pretendimet/dyshimet e Albtelecom dhe kërkesa për vënien në dispozicion nga Elite Telecommunication të kopjeve të kontratave me pajtimtarët, faturat mujore etj., që kanë gjeneruar trafikun e dyshuar, janë në përputhje me MI-në e nënshkruar midis palëve. Njoftimet dhe masat e ndërmarra nga Albtelecom rezultojnë se janë në përputhje me përcaktimet e ORI të miratuar nga AKEP dhe MI-së së nënshkruar midis palëve.
- h. Ndërkohë në lidhje me verifikimin për përdorim të numeracionit/rrjetit në përputhje me kuadrin ligjor/rregullator është e nevojshme inspektimi në terren në operatorin Elite Telecommunication.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar Ligjin nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 114, neni 115 si dhe Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015) neni 130 e në vijim,

## **V E N D O S:**

1. Të mbyllë procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Elite Telecommunication sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. të nisur me VKD nr.14, datë 20.07.2017.
2. Të mos pranojë kërkesat e Elite Telecommunication për këtë mosmarrëveshje me Albtelecom sh.a.
3. Të njoftohen palët e interesuara Elite Telecommunications sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Palët kanë të drejtën e ankimit të këtij vendimi në rrugë gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)  
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Ilir ZELA**

## **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI